



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E FINANCËS DHE PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

Nr. 8563 prot.

Himarë, më 25.11.2025

Lënda: Shkresë përcjellëse mbi relacionin informacion mbi realizimin e treguesve ekonomikë për periudhën Janar - Tetor 2025.

KESHILLIT BASHKIAK HIMARË

KËTU

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8, neni 9/1 pika 1/1 a dhe b, pika 1/3 c, nenet 10, 24, 40/4, 54/k; Mbështetur në nenet 34,40,41,45,55 të ligjit nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin 9936 datë 26.08.2008 "Për Menaxhimin e Sistemimin Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 "Për Financat e Qeverisjes Vendore" ligjin Nr 10296 datë 08.07.2010. "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

1. Informacionin e realizimit të treguesve ekonomik për periudhën Janar - Tetor 2025

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel TAVO

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Erifili Berberi

Konceptoi: J. Kollagji

Miratoi: B.Xhaferi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E FINANCËS DHE PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

Nr. ____ prot.

Himarë , më __ . __ . 2025

**INFORMACION MBI REALIZIMIN E TREGUESVE EKONOMIKË PËR
PERIUDHËN JANAR-TETOR 2025.**

Hyrje

- Baza ligjore dhe qëllimi i raportit

Analiza e të Ardhurave

- Plani dhe realizimi i të ardhurave për periudhën 10-mujore
- Analiza e devijimeve dhe faktorëve ndikues

Analiza e Shpenzimeve

- Plani dhe realizimi i shpenzimeve për periudhën 10-mujore
- Kategori kryesore të shpenzimeve dhe analiza e devijimeve

Performanca Financiare e Përgjithshme

- Krahasimi midis planit dhe realizimit të përgjithshëm
- Performanca e njësive kryesore

Rekomandimet

- Masat për përmirësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve
- Veprimet e nevojshme për realizimin e planit vjetor

Përfundimi

- Përmbledhje e ecurisë së deritanishme dhe pritshmëritë për periudhën e mbetur

Hyrje

1.1. Qëllimi i Raportit:

Të nderuar këshilltarë,

Ky raport synon të paraqesë një analizë të detajuar mbi realizimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë për periudhën 10-mujore të vitit 2025, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e Bashkisë Himarë. Ai shërben për të informuar Këshillin Bashkiak mbi performancën financiare të bashkisë, devijimet nga plani fillestar, dhe për të dhënë rekomandime për përmirësimin e menaxhimit financiar në periudhën e mbetur të vitit.

1.2. Baza Ligjore:

Hartimi i këtij raporti mbështetet në disa akte ligjore të rëndësishme, si më poshtë:

- **Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,** i cili përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e bashkive për menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Ky ligj, në nenet 8, 9, 10, 24, 40 dhe 54, vendos bazat për buxhetimin dhe menaxhimin financiar të bashkive.
- **Ligji Nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,** i ndryshuar, ku në kreun III (nenet 10-20) dhe kreun IV (nenet 20-29), përcaktohen procedurat për planifikimin dhe realizimin e buxhetit të bashkisë.
- **Ligji Nr. 68/2017 “Për Financat e Qeverisjes Vendore”,** i cili rregullon burimet e financimit të bashkive, si dhe standardet për menaxhimin e tyre. Nenet 39 dhe 40 të këtij ligji vendosin detyrime për bashkitë në lidhje me raportimin financiar dhe përgjegjësitë në menaxhimin e buxhetit.
- **Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,** që përcakton sistemet e kontrollit financiar të brendshëm për të siguruar një menaxhim të përgjegjshëm të fondeve publike.

Analiza e Shpenzimeve

Plan i shpenzimeve për periudhën 10-mujore të vitit 2025 është hartuar duke u bazuar në projektet dhe shërbimet që Bashkia Himarë synon të realizojë gjatë vitit. Shpenzimet përfshijnë investimet në infrastrukturë, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e shërbimeve publike, dhe pagesat për stafin dhe kontraktorët.

Më poshtë është një përmbledhëse që tregon planin vjetor, planin për periudhën 10-mujore dhe realizimin e shpenzimeve gjatë kësaj periudhe:

plan	fakt
602	602

341,303,024.00 183,446,319.00

230-231	230-231
---------	---------

2,186,595,920.00 343,561,080.00

Total buxheti	
plan	total buxheti fakt

2,936,747,050.00 786,810,035.07

Pavarësisht sfidave të hasura gjatë periudhës 10-mujore të vitit 2025, Bashkia Himarë mbetet e përkushtuar në përmbushjen e planit financiar të këtij viti. Si një institucion që ka për synim zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët, bashkia ka hartuar një strategji për të vazhduar me realizimin e të ardhurave dhe për të impenuar buxhetin për të gjitha investimet e planifikuara për vitin 2025.

Këto investime janë të rëndësishme për përmirësimin e infrastrukturës vendore dhe ofrimin e shërbimeve publike, dhe për këtë arsye do të vazhdojnë sipas afateve të përcaktuara në buxhetin e këtij viti. Në përputhje me legjislacionin përkatës dhe me masat e marra nga administrata, Bashkia Himarë do të sigurojë që të pjesa me e madhe e investimeve të regjistruara dhe të planifikuara të nisin brenda vitit ushtrimor.

Ndërkohë që pagesat do të kalojnë në vitin buxhetor të ardhshëm, për shkak të afateve të lidhjes së kontratave dhe ekzekutimit të punimeve, këto pagesa do të përfshihen në buxhetin e vitit 2026. Kjo do të bëhet në përputhje me ligjin dhe në mënyrë që projektet të mos pësojnë

vonesa të mëtejshme. Fondet do të impenjohen për projektet që janë përfshirë në buxhetin tre-vjeçar të miratuar, duke siguruar që Bashkia të ruajë ritmin e saj të zhvillimit dhe të përmbushë objektivat e saj të investimeve strategjike.

Në përfundim, Bashkia Himarë mbetet e përkushtuar për të siguruar që të gjitha projektet prioritare të parashikuara për vitin 2025 të nisin brenda këtij viti, ndërsa do të vijojë të monitorojë dhe të planifikojë investimet për periudhën e ardhshme, duke garantuar që projektet e nisura në vitin 2025 të përfundojnë brenda kornizës financiare të planifikuar për vitin 2026.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel TAVO

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Erifili Berberi



Konceptoi: J. Kolagji

Miratoi: B. Xhaferi